

## KUSHTET DHE RREGULLAT E PJESËMARRJES NË LOJËN SHPERBLYESE TË ORGANIZUAR NGA IPKO TELECOMMUNICATIONS LLC

### Neni 1 - Kushtet e Përgjithshme

- 1.1 Kushtet e Përgjithshme për pjesëmarrje në **LOJËN SHPERBLYESE** për abonentët e IPKO-qeverisin të drejtat, detyrimet dhe kushtet për pjesëmarrjen në **LOJËN SHPERBLYESE** të organizuar nga "IPKO Telecommunications LLC" (IPKO).
- 1.2 Këto kushte publikohen në faqen zyrtare të IPKO's [www.ipko.com](http://www.ipko.com).

### Neni 2- Afati i organizimit të lojës shpërblyese

Loja shpërblyese do të organizohet nga data 14 nëntor 2017 dhe do të zgjasë për 30 ditë, përkatësisht deri me datë 14 dhjetor 2017.

### Neni 3 - Anëtarësimi dhe pjesëmarrja

- 3.1 Të drejtë pjesëmarrje në lojën shpërblyese kanë: të gjithë përdoruesit privat dhe ata të bizneseve, të cilët aktivizojnë pako të internetit në mobil: 10 GB për 2.50 EUR kështu duke u bërë automatikisht pjesëmarrës të lojës për të fituar një nga shpërblimet e lartcekura.
- 3.2 Punëtorët e IPKO's si dhe familjarët e tyre nuk kanë drejtë pjesëmarrje në lojën shpërblyese.
- 3.3 Përdoruesit nuk do të kenë kufizim në aktivizimin e pakove, rrjedhimisht sa më shumë pako që ata aktivizojnë aq më e madhe do të jetë mundësia që ata të jenë fitues të shpërblimeve të lartcekura.
- 3.4 Në rastet kur fitues i një shpërblimi të caktuar është pjesë e një Biznesi, shpërblimi i takon Përdoruesit/shfrytëzuesit të numrit.
- 3.5 Për të marrë pjesë në lojën shpërblyese Përdoruesit duhet të aktivizojnë pako të internetit, përmes kodit \*100# - 10GB me validitet 7 ditë. Çmimi i pakos është 2.50€. Kontrollimi i MB bëhet përmes \*100\*1#.

### Neni 4 – Organizimi i Lojës Shpërblyese

4.1 Përzgjedhja e fituesve bëhet në mënyrë manuale (me dorë), ku numrat e të gjithë pjesëmarrësve do të shtypen në letra të vogla, të cilat do të vendosen në një gotë qelqi, duke zgjedhur manualisht secili prej 20-40 fitues për çdo javë (për katër javë me radhë) dhe në fund për shpërblimin **Veture Premium Luxury**, do të zgjidhet një fitues nga të gjithë pjesëmarrësit që kanë aktivizuar pako prej ditës së parë të fillimit të lojës shpërblyese, gjegjësisht prej datës 14 nëntor deri me datë 14 dhjetor 2017, sipas metodologjisë së njëjte.

Informacionet e detajuara për javët si në vijim:

1. Java e parë: 14 nëntor – 22 dhjetor (fituesit zgjedhën me 23 nëntor);
2. Java dytë – 23 nëntor – 29 nëntor (fituesit zgjedhën me 30 nëntor);
3. Java tretë – 30 dhjetor – 6 dhjetor (fituesit zgjedhën me 7 dhjetor);
4. Java e katërt – 7 dhjetor – 14 dhjetor (fituesit zgjedhën me 14 dhjetor).

4.2 Fituesit do të përzgjidhen përmes programit televiziv që do të transmetohet në Klan Kosova- emisioni Ora e Pasdites.

4.3 Komisioni për tërheqjen e shpërblimeve do të jetë në përbërje të 3 anëtarëve, 2 anëtarë të përzgjedhur nga IPKO si dhe përfaqësuesi i ATK në cilësinë e kryetarit të Komisionit. ATK do të njoftohet paraprakisht mbi vendin dhe kohën e tërheqjes së shpërblimeve.

4.4 IPKO rezervon te drejtën e ndryshimit të datave në afat prej 3 ditësh para tërheqjes së shpërblimeve.

4.5 Fituesit mund të bëjnë tërheqjen e shpërblimeve në lokacionin e përcaktuar nga IPKO's jo më vonë se 60 dite nga dita e tërheqjes së shpërblimit . Përdoruesi ka për obligim që të këtë me vete ID dhe numrin e telefonit mobil, për të dëshmuar që është fitues dhe ta tërheq shpërblimin.

4.6 IPKO do të bëjë verifikimin e fituesve të shpërblimeve bazuar në verifikimin të dhënave personale në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm në Kosovë.

## 5- Shpërblimet

5.1 Te gjitha shpërblimet që janë pjesë e kësaj loje shpërblyese do të publikohen në faqen zyrtare të IPKO's [www.ipko.com](http://www.ipko.com), përkatësisht fondi i shpërblimeve do të jete si në vijim:

Shpërblimet që do të jepen për fituesit, janë përcaktuar në vijim në baza javore:

Fituesit nga java e parë: 14 nëntor – 22 nëntor, do të fitojnë 20 shpërblime:

- 1 x Veture (Compact SUV)
- 1 x Veture (Category B)
- 2 x Iphone X
- 2 x Iphone 8
- 2 x Samsung Galaxy S8
- 2 x aranzhmane turistike
- 2 x shërbime të Ipkos
- 2 x 500 Euro

- 2 x iPad
- 2 x Tablete
- 2 x Laptop

Fituesit nga java e dytë: 23 nëntor – 29 nëntor , do të fitojnë 20 shpërblime:

- 1 x Veture (Mid-Size SUV)
- 1 x Veture (Category B)
- 2 x Iphone X
- 2 x Iphone 8
- 2 x Samsung Galaxy S8
- 2 x aranzhmane turistike
- 2 x shërbime te Ipkos
- 2 x 500 Euro
- 2 x iPad
- 2 x Tablete
- 2 x Laptop

Fituesit nga java e tretë: 30 nëntor – 6 dhjetor, do të fitojnë 20 shpërblime:

- 1 x Veture (Mid-Size SUV)
- 1 x Veture (Compact SUV)
- 2 x Iphone X
- 2 x Iphone 8
- 2 x Samsung Galaxy S8
- 2 x aranzhmane turistike
- 2 x shërbime te Ipkos
- 2 x 500 Euro
- 2 x iPad
- 2 x Tablete

- 2 x Laptop

Fituesit nga java e katërt: 6 dhjetor – 14 dhjetor, do të fitojnë 40 shpërblime:

- 1 x Veture (Luxury Premium)
- 1 x Veture (Mid-Size SUV)
- 1 x Veture (Compact SUV)
- 1 x Veture (Category B)
- 2 x Iphone X
- 2 x Iphone 8
- 2 x Samsung Galaxy S8
- 2 x aranzhmane turistike
- 2 x shërbime te Ipkos
- 2 x 500 Euro
- 2 x iPad
- 2 x Tablete
- 2 x Laptop

5.2 Shpërblimet nuk mund të konvertohen në para të gatshme.

## Neni 6 – Detyrimet e pjesëmarrësve

6.1 Duke marrë pjesë në lojën shpërblyese, çdo pjesëmarrës i jep pëlqim **IPKO Telecommunications** për të redaktuar, modifikuar, përshtatur, përkthyer, eksponuar, publikuar, transmetuar, duke përfshirë riprodhim, kopjim, të krijojë vepra përkatësisht të përdor të gjithë dhe / ose ndonjë pjesë të emrit, ngjashmërisë, fotografisë, zërat të pjesëmarrësit dhe imazhet e të gjithë personave të cekur dhe/ose që shfaqen në materialet e krijuara në ngjarje, pa kufizim, kudo në botë, në çdo formë (të prekshme dhe paprekshme, të përhershme apo kalimtare, duke përfshirë, pa kufizim, audio, video, të shtypura, elektronike, me shkrim, dhe fotografike) dhe nëpërmjet çdo mediumi të transmetimit (duke përfshirë, pa kufizim, televizion, radio, internet, dhe të shtypura) tani ekzistuese ose që mund të ekzistojnë në të ardhmen për reklamat, tregti, promovim, publicitet dhe qëllime të tjera të ngjashme pa kompensim dhe pa njoftim për ose në konsideratë, rishikim ose aprovim nga pjesëmarrësi.

6.2 Çdo pjesëmarrës më tej bie dakord të:

**6.2.1** Të merret në pyetje ose intervistohet (qoftë personalisht ose me mjete të tjera të tilla si email ose telefon), filmohet dhe/ose të fotografohet dhe të jetë i disponueshëm për intervistim, xhirim, fotografim dhe për marrëdhënie të tjera publike, marketing dhe aktivitete promovuese që lidhen me ngjarje, siç kërkohet në mënyrë të arsyeshme dhe të drejtuara nga IPKO.

**6.2.2** Lejojë IPKO-n të kontaktojë pjesëmarrësit (qoftë personalisht, me telefon, email ose përndryshe) me qëllim për të kërkuar informata të tjera nga pjesëmarrësit në lidhje me pjesëmarrjen e tyre ose për ndonjë qëllim tjetër që lidhet me lojën shpërblyese. Çdo Pjesëmarrës përfaqëson dhe garanton se pjesëmarrjen e tij, dhe as ushtrimi i ndonjë prej të drejtave të dhëna IPKO-s asaj sipas këtyre Kushteve nuk do të:

**6.2.2.1** shkelë apo cenon ndonjë të drejtë të ndonjë subjekti apo pale të tretë, duke përfshirë, pa kufizim, ato që lidhen me patentat, të drejtat e autorit, markat tregtare, sekretet tregtare, të drejtat morale, privatësinë, publicitetin, shpërdorimin, konfidencialitetin, dhe/ose ndonjë të drejtë kontraktuale ose të tjera të njohura nën çfarëdo ligji, rregulle, rregullore, urdhëresë, aktgjykim apo dekret (kolektivisht, "Ligji"), ose ndryshe shkelin ndonjë ligj të zbatueshëm.

6.3 IPKO rezervon të drejtën që të revokoj pjesëmarrjen në lojën shpërblyese të gjithë Përdoruesve të për të cilët IPKO konsideron që bëjnë keqpërdorime apo shkelin ndonjërin prej kushteve të përcaktuara në këtë dokument, duke përfshirë shumën e mëdha të mbushjeve apo transferimin e mbushjeve në vlera të mëdha, tek palët e treta .

## **Neni 7 – Bartja e të drejtave dhe detyrimeve**

7.1 Përdoruesi nuk ka të drejtë të transferojë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo marrëveshje palëve të treta pa miratimin paraprak me shkrim nga IPKO.

7.2 IPKO rezervon të drejtën për të transferuar të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo marrëveshje pasuesit ligjor të IPKO-s.

## **Neni 8 - Përdorimi i të dhënave personale**

IPKO do të ruajë informacionin personal të pjesëmarrësve në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të dhënave Personale Nr. 03 / L0-172.

## **Neni 9- Kushtet e përfundimtare**

9.1 IPKO rezervon të drejtën për të mos shpërblyer pjesëmarrësit, nëse:

- Lindin dyshime në lidhje me identitetin e të dhënave;
- Kuptohet që një pjesëmarrës i ngjarjes ka vepruar në kundërshtim me këto kushte.

9.2 IPKO nuk do të marrë asnjë përgjegjësi për:

- Shërbimet ose aplikacionet jo-funksionale, të cilat janë një rezultat i jo njohurive për përdorimin e shërbimeve ose aplikacioneve;
- Mosfunksionimin e shërbimeve ose aplikacioneve, si pasojë e rënies në rrjetin e internetit, rënien e rrjeteve, mungesës së energjisë elektrike apo pengesave të tjera teknike, të cilat përkohësisht mundet të parandalojnë përdorimin e shërbimit ose aplikacionit;
- Ndonjë pasojë të padëshiruar që lind nga pjesëmarrja në ngjarje;

9.3 IPKO nuk do të marrë përgjegjësi për ndonjë dëm ose dëmtim, që është krijuar nga pjesëmarrësit gjatë pjesëmarrjes në ngjarje;

9.4 Këto kushte hyjnë në fuqi më **14.11.2017**.